

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve në administratën shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11), dhe Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *arsimi teknik* për klasën VI (e gjashtë) në arsimin fillor nëntëvjeçar për vitin shkollor 2020/2021.

## 1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën mësimore arsimi teknik për klasën VI (e gjashtë) në arsimin fillor nëntëvjeçar bazohet në qëllimet /rezultatet e parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që realizohet rregullisht në bazë të planit mësimor të caktuar.

Me programin e shkurtuar përcaktohen tema të caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen për 159 ditë mësimore, megjithatë duhet të ruhet fondi favor i orëve të parapara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndë mësimore me 1 orë në javë parashikohen 32 orë mësimore në programin e shkurtuar.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të përcaktuara në programin mësimor të rregullt.

## 2. Pasqyra e temave

	ORËT
VIZATIMI TEKNIK DHE DIZAJNI	6
PUNA ME MATERIALE DHE KONSTRUKTIMI	22

KOMUNIKACIONI	4
Gjithsej	32

Tema: VIZATIMI TEKNIK DHE DIZAJNI –6 orë

- Llojet e vizatimit teknik-dhe vizatimi i figurave të thjeshta, skicë dhe vizatim teknik 1
- Dizajnimi -Elementet dhe fazat e dizajnit -1
- Dizajnimi grafik, - ideja, skicë, zgjidhja - përpunimi 1
- Vizatimi teknik dhe dizajnimi me aplikimin e TIK aplikacioneve (zgjidhja grafike, enterieri, eksterieri) 1

Njësitë mësimore	Gjithsej orë
Llojet e vizatimit teknik – vizatimi i skicës dhe vizatimi teknik	1
Vizatimi i pikturave dhe pikturave të thjeshta- ushtrime për vizatimin e trupave gjeometrik, ushtrime për vizatim teknik	2
Përpunimi i dizajnit grafik – idea, skicë, zgjidhje	1
Vizatimi teknik dhe dizajnimi me TIK, zgjidhja grafike, enterieri dhe eksterieri	2

## Tema: PUNA ME MATERIALE DHE KONSTRUKTIMI - 22 orë

### Njësitë mësimore

- Planifikimi, procedurat dhe dizajnimi me materiale gjatë ndërtimit të maketave, modeleve - 2
  - Ndërtimi dhe konstruktimi me materiale të thjeshta (dru, karton, letër, tekstil, tel i butë)- 2
  - Elementet e bartjes në lëvizje dhe zbatimi i tyre në modele dhe konstruktime – rripi, rrota lëvizëse me rrip, boshti, dhëmbëzorët-2
  - Zbatimi i pajisjeve elektrike, elektronike në tension të ulët te modelet (bateria, elektromotori, llamba)-2
  - Zbatimi i pajisjeve për lëvizje dhe drejtim të lidhur me kompjuter -1
  - Nga ideja deri te realizimi i prodhimit të gatshëm / maketa: Arkitektura maqedonase / shqiptare/ turke ose tjeter 2
  - Materialelet ndërtimore dhe zbatimi i tyre në ndërtimin bashkëkohor dhe kursimi i energjisë në ndërtimtari-1
- Përsëritje dhe konfirmime

Zbatimi i materialit teknik- -Letër, karton, dru dhe tekstil	2
Planifikimi i procedurave dhe dizajnimi gjatë punës me materiale në ndërtim: Trupa gjeometrik, kutia për dhuratë – dizajn dhe formësim	2
Ndërtimi dhe konstruktimi me zbatimin e materialeve të thjeshta : dru, karton, letër, tekstil, tel i butë, strajcë për porositë, përpunimi nga tekstili, prodhimi sipas përzgjedhjes individuale- detyra punuese - Detyra - bëje një aeroplan nga materiali i kombinuar	4
Elementet e bartjes së fuqisë dhe lëvizjes dhe aplikimi i tyre te modelet dhe konstruksionet: rrota lëvizëse me rrip, boshti, dhëmbëzorët	1
Pajisjet elektrike dhe elektronike në tension të ulët te modelet/ bateria, elektromotori dhe llamba	1

Zbatimi i pajisjeve elektronike në konstruksione dhe modele Qarku elektrik- Modeli i semaforit, detyrë punuese - tension i ulët	2
Nga idea deri te realizimi – Konstruksioni i automjetit, sportiv ose tjetër-detyrë punuese/ndërlidhje me TIK/mikrobit	2
Arkitektura – përgatitja për ndërtimin e shtëpisë nga maketa - përgatitje për ndërtimin e një makete - shtëpi	1
Materialet ndërtimore dhe zbatimi i tyre në ndërtimin bashkëkohor	1
Kursimi i energjisë në ndërtimtari	1
Nga ideja deri në objekt/prodhim të gatshëm -Shtëpi me energji diellore - Shtëpi e vjetër maqedonase	3
Zgjidhja e situatave në komunikacion	1
Përsëritje dheparaqitja e asaj që është punuar	1

#### TEMA: KOMUNIKACIONI– 4 orë

Njësitë mësimore

Zbatimi i rregullave dhe dispozitave në komunikacionin rrugor	1
Zgjidhja e situatave problematike në komunikacion	1
Zbatimi i aplikacionit softuerik për realizimin e situatës në komunikacion/aplikimi i TIK	2

### **3. Rekomandimet didaktike**

#### *Udhëzimet për ndërlidhjen ndërlendore*

Përbajtjet mësimore të lëndës mësimore *arsimi teknik*, jep mundësi për integrimin e përgjithshëm dhe ndërlidhje përbajtësore me lëndët mësimore si: informatikë, shkenca natyrore, matematikë, arsim figurativ, njohja me mjedisin dhe krijimtaria. Mësimdhënësi e realizon dhe bën përshtatjen e programit në përputhje me moshën, përkatësisht klasën e nxënësit, interesimin dhe paranjohuritë e tyre.

Qëllimet e parashtruara në tema jep mundësinë e planifikimit dhe realizimit të përbajtjeve dhe aktivitetave në përputhje me moshën, avancimet, nevojat, interesimet, njohuritë paraprake dhe të arriturat e nxënësve, si dhe respektimi i parimit, i aktualizimit- dhe realizimi i tyre. Pastaj shfrytëzohen shembuj aktual dhe shembuj të ri teknologjik dhe procese të punës- dizajni dhe teknologjia, të cilat duhet të ndërlidhen me përvojën e arritur të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj. Gjatë demonstrimit nxënësit mësohen të përdorin procedura, elemente dhe pajisje me hulumtim problematimk të detyrave dhe udhëzohen në aplikimin e njohurive të arrituara dhe shkathtësitë në jetën dhe praktikën e përditshmërisë. Në programin mësimor, gjithashtu janë dhënë edhe qëllimet e konkretizuara të cilat arrihen përmes aktivitetave të nxënësve për kreativitet, risi dhe shkathtësi gjatë punës me materiale. Gjatë klasës së gjashtë nxënësit do të kenë mundësinë të njoftohen dhe të aftësohen për realizimin e ideve të tyre dhe realizimin e idesë në prodhim të gatshëm, konstruktim- maketë ose modele, madje edhe funksional për qëllime dhe shfrytëzime të caktuara. Programi mësimor i shkurtuar iu mundëson nxënësve të fitojnë njohuri dhe shkathtësi për aplikimin e materialeve dhe komponenteve, sistemeve për kontrollë, strukturave, prodhimeve ekzistuese, cilësi, shëndet dhe siguri. Ky qëllim i përpilimit të programeve mësimore mendojmë se te nxënësit do të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e krijimtarisë teknike, risive, kreativitet dhe aftësimit për organizim.

Aktivitet e parapara në programin mësimor për klasën e gjashtë ngërthejnë shumë qëllime specifike të cilat mund të realizohen me forma, metoda, modele të ndryshme bashkëkohore dhe qasje.

Përshkak të specifikave/ shkurtimi i orëve mësimore për nga numri dhe kohëzgjatja e tyre, mund të bashkohen/ kombinohen përbajtjet, aktivitetet si dhe metodat e ndryshme të punës. Disa aktivitete nxënësit mund t'i punojnë (përfundojnë) edhe gjatë aktiviteteve jashtëmësimore ose gjatë kohës së lirë, qofshin të karakterit hulumtues ose punë praktike.

Përpunimi i modelit të përgjithshëm, maketë, dizajnimi mund të punohet edhe në faza, edhe pse më së miri do të ishte në shkollë të bashkohen dy orë në bllok orë me punë të njëherershme. Realizimi i qëllimeve është që të krijojnë prodhimet, t'i shohin, t'i prekin, t'i shijojnë, të krenohen me atë që e kanë bërë. Gjithashtu, mësimdhënësit mund ta arrijnë këtë përmes aktiviteteve të ndryshme, mënyrave të ndryshme duke përdorë materiale të reja përkatëse didaktike dhe teknologji, situata me qëllim të krijimit të bazës për mësimnxenie të lëndës. Të ofrojnë video, linqe të materialeve elektronike, udhëzime të linqeve përkatëse dhe gjithsesi të gjejnë mënyra për ta kontrolluar atë që e kanë punuar nxënësit.

Gjatë hulumtimit, konstruktimit dhe demonstrimit nxënësit udhëzohen të përdorin procedura dhe instrumente në njojjen, shkëmbimin dhe zbatimin e njojurive të fituara në jetën e përditshme dhe në praktikë. Mund të përdorin ngjarje aktuale të punës dhe teknologjike, situata, procese të punës dhe të njëjtat ndërlidhen me përvojnën e fituar të nxënësve në shkollë dhe jashtë saj.

Edhe pse zvogëlohet numri i orëve – përbajtjet dhe aktivitetet të planifikohen dhe realizohen me ndërlidhje, bashkim ku arrihen rezultatet e pritura me të cilat kultivohet kreativiteti, risia përmes dizajnit, hulumtimi i botës së dizajnit në të cilën jetojmë ne. Në pikëpamje të hapësirës, nevojitet shfrytëzimi i punëtorisë nga arsimi teknik në shkollë. Në qoftë se nuk ekziston një hapësirë e tillë atëherë kusht minimal është që shkolla të sigurojë një komplet veglash dhe mjetesh sipas normativit të caktuar për lëndën arsimi teknik dhe përbajtjet e reja për këtë program dhe të njëjtat të shfrytëzohen në klasë klasike.

Lënda mësimore arsimi teknik për klasën VI ( e gjashtë) mësohet me 1 orë në javë, përkatësisht 32 orë në vit.

#### **4. Normativi për kuadrin mësimor**

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në bazë të normativit për kuadrin mësimor të dhënë në programin mësimor të rregullt.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *Arsimi teknik* për klasën VI (e gjashtë) në arsimin fillor e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska